

## **MATERIAL MËSIMOR**

**Në mbështetje të mësuesve të profilit mësues**

### **“SILVIKULTURË”**

**Niveli IV i KSHK**

**Ky material mësues i referohet:**

- **Lëndës profesionale: “Gjeodezi dhe planifikim territori” kl. 13 (L-03-229-17)**

**Përgatiten:  
Gjon Fierza  
Ndue Çuni**

**Tiranë, 2023**

# **Tema 1: Objekti, rëndësia e mbrojtjes së mjedisit e planifikimit të territorit.**

## **Përkufizime të rëndësishme**

Është e rëndësime të njihën disa përkufizime, lidhja midis tyre dhe ndryshimi.

Natyra është dhe përfshinë:

1. Gjithësinë me tërë sendet dhe qeniet, e cila zhvillohet sipas ligjeve të caktuara, bota organike dhe joorganike. Natyra e gjallë bota organike. Natyra e vdekur bota joorganike. Forcat e natyrës. Ligjet e natyrës. Dukuritë e natyrës. Studimi i natyrës. Shkencat e natyrës fizika, kimia, biologjia, matematika, etj.

2. Mjedisi në të cilin rron njeriu në Tokë, me të gjitha qeniet e gjalla dhe sendet pa jetë. Mbrojtja e natyrës. Vështirësitë e natyrës. Fatkeqësitë e natyrës. Kalendari i natyrës. Qarkullimi i ujit në natyrë.

3. Pamja e një vendi me malet, fushat, lumenjtë, bimësinë etj. vend jashtë qytetit. Natyrë e bukur (e egër, e ashpër). Natyra shqiptare. Në gjirin e natyrës. Jashtë në natyrë. Mësim në natyrë. Dolën në natyrë. Jeton në natyrë.

4. Në formë figurative. Tërësia e vetive kryesore të brëndshme, që përcaktojnë thelbin e diçkaje; veti thelbësore që e dallon diçka, thelbi. Natyrë njerëzore. Natyra e rendit (e sistemit, e shtetit). Natyra e kontradiktave (e dukurive). Zbulon (fsheh) natyrën e vet. Nuk e ndryshon natyrën.

Mjedisi është dhe përfshinë.

Tërësia e kushteve natyrore, në të cilat jeton e zhvillohet njeriu a një qenie tjetër, ndodhet e ndryshon një send, zhvillohet një dukuri etj.; gjithçka që rrethon një organizëm dhe ndikon mbi të; hapësira a sendet që na rrethojnë; ambient. Mjedisi rrethues. Mjedisi gjeografik. Mjedisi i jashtëm. Mjedisi urban. Mjedisi pyjor.

Përshkrimi i mjedisit.

2. Kushtet shoqërore dhe të jetës, në të cilat rron e vepron njeriu; grup njerëzish të një profesioni etj. a me kushte të tilla të përbashkëta, në gji të të cilit rron e punon dikush; ambient. Mjedisi shqiptar. Mjedisi arbëresh. Mjedisi punëtorësh. Mjedisi shoqëror. Mjedisi i huaj. Mjedisi i ftohtë.

Mjedisi natyror quhet vendi, njerëzit, gjërat, natyra përreth nesh dhe çdo organizëm tjetër i gjallë. Mjedisi natyror përfshin të gjitha gjallesat ashtu si edhe gjithë botën jo të gjallë natyrore, domethënë në këtë rast jo artificiale. Termi më së shpeshti nënkupton Tokën ose disa pjesë të Tokës. Ky mjedis përfshin: ndërveprimin e të gjitha llojeve të gjalla, klimës, motit dhe burimeve natyrore që ndikojnë në mbijetesën njerëzore dhe aktivitetin ekonomik.

Planifikimi i territorit paraqet aktivitet të vetëdijshëm dhe shoqëror të organizuar në lidhje me:

Rregullimin dhe shfrytëzimin e hapësirës natyrore-gjeografike

Ndërtimin e infrastrukturës ekonomike (energji elektrike, ujësjellësi, rrugët etj.) dhe infrastrukturës shoqërore (institucioneve shëndetsore, arsimore, sociale, kulturore, sportive etj.)

Rregullimin dhe zhvillimin e qendrave, zonave dhe drejtimeve të ndryshme

Rregullimin dhe zhvillimin e qendrave të qyteteve dhe fshatrave.

Rregullimi i zonave bujqësore dhe turistike, po ashtu janë element i planifikimit të hapësirës

Në aspektin dinamik, shfrytëzimi i resurseve duhet të bëhet me dinamikë të planifikuar, pasi shfrytëzimi i pakontrolluar mund të sjellë deri te prishja e baraspeshës natyrore, si dhe deri te bllokimi i zhvillimit ekonomik

Mjedisi urban (zonë urbane), është territori ku është ndertuar vendbanim njerëzor me një dendësi të lartë popullore dhe infrastrukturë të mjedisit. Mjediset urban (zonat urbane) krijohen përmes urbanizimit dhe kategorizohen si qytete, qyteza, bashkime ose periferi. Në urbanizëm, termi është në kontrast me zonat rurale si fshatrat dhe fshatrat; në sociologjinë urbane ose antropologjinë urbane është në kontrast me mjedisin natyror. Krijimi i paraardhësve të mëhershëm të zonave urbane gjatë revolucionit urban çoi në krijimin e qytetërimit njerëzor me planifikim modern urban, i cili së bashku me aktivitetet e tjera njerëzore si shfrytëzimi i burimeve natyrore çoi në një ndikim njerëzor në mjedis.



## 1.2 Objekti i planifikimit të territorit

Objekti dhe detyrat e planifikimit të territorit mbështetet në ligjet natyrore dhe shoqërore për shkëmbim të materies ndërmjet njeriut dhe mjedisit, që realizohet nëpërmjet procesit të prodhimtarisë, si veprimtari tëvetëdijshëm tënjeriut me të cilin drejtpërsëdrejti ndikon në ndryshimin e natyrës, zotëron me të dhe e përshtat sipas nevojave të tij.

Planifikimi i territorit është disiplinë shkencore shoqërore që studjon, zbulon dhe përshkruan ligjet objektive të proceseve zhvillimore në hapësirë, si dhe përcakton parimet, kriteret, metodat, instrumentet dhe masat e nevojshme për organizimin e hapësirës nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të planeve të territorit të niveleve të ndryshme, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të shoqërisë së civilizuar

#### Parimet

Planifikimi dhe zhvillimi i territorit bazohet në këto parime:

- a) Zhvillimi duhet të jetë i qëndrueshëm dhe të garantojë nevojat e brezave për barazi sociale, zhvillim ekonomik dhe mbrojtje të mjedisit;
- b) Zhvillimi i territorit është çështje e rëndësisë kombëtare; ai duhet të jetë i drejtë dhe vlera e krijuar të përftohet dhe të përvetësohet nga shoqëria që e krijon atë;
- c) Planifikimi duhet të harmonizojë interesat publike e private, kombëtare e vendore;
- ç) Zhvillimi duhet të udhëhiqet nga planifikimi, i cili është i detyrueshëm për të gjitha autoritetet e planifikimit, sipas këtij ligji;
- d) Parimet dhe vlerat e dokumenteve të planifikimit duhet të kenë vazhdimësi edhe pas ndryshimit të tyre;
- dh) Transparenca duhet të shoqërojë proceset e planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit;
- e) Shërbimi me një ndalesë;
- ë) Heshjtja është miratim;
- f) Planifikimi duhet të marrë në konsideratë karakteristikat e kontekstit të territorit në zhvillim;
- g) Decentralizimi dhe subsidiariteti;
- gj) Harmonizimi me qasjen e Bashkimit Evropian në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit të territorit, si edhe lidhur me kriteret mjedisore, ruajtjen e biodiversitetit dhe të zonave të mbrojtura;
- h) Zhvillimi duhet të bazohet në planifikimin dhe projektimin e gjithanshëm, gjë që garanton kushte të barabarta dhe të drejta për të gjithë qeniet, pavarësisht nga nevojat dhe karakteristikat e secilit;
- i) Planifikimi dhe zhvillimi duhet të garantojnë eliminimin e barrierave për një përdorim të sigurt, të barabartë e të pavarur të hapësirave nga të gjithë personat, përfshirë ata me aftësi të kufizuara ose grupe të veçanta, për të cilët janë të nevojshme zgjidhje teknike apo pajisje të veçanta;
- j) Hierarkia e planeve;
- k) Shpërndarja e të drejtave të zhvillimit duhet të jetë e drejtë dhe në bazë të parimit të proporcionalitetit;
- l) Sigurimi i detyrueshëm i objekteve, i përgjegjësive civile dhe profesionale në ndërtim;
- ll) Garantimi i aksesit dhe i pjesëmarrjes së publikut në hartimin e dokumenteve të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit;
- m) Sistemi i integruar i planifikimit.

njerëzore. Pikërisht planifikimi i territorit analizon zhvillimin e përgjithshëm ekonomik shoqëror në aspekt territorial, duke i marrë parasysh të gjitha karakteristikat e territorit që është objekt hulumtimi, në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të hapësirave të veçanta në nivel rajonal, nacional dhe ndërkombëtar.

Planifikimi dhe zhvillimi i territorit ka rëndësi dhe synon:

- a) të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore;
- b) të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave

ekonomike e njerëzore dhe interesave publikë e privatë, duke bashkërenduar punën për:

- i) mbrojtjen e burimeve natyrore, si: toka, në veçanti toka bujqësore, ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet;
- ii) krijimin e garantimin e territoreve të ndërtueshme, të organizuara në mënyrë të harmonizuar e funksionale, duke i dhënë përparësi hapësirës publike, mundësisë së banimit për të gjitha shtresat ekonomike e sociale, krijimit të infrastrukturës fizike të përshtatshme për nxitjen e investimit në ushtrimin e



veprimtarive ekonomike, sociale e kulturore, lehtësimit të përdorimit të sigurt të shërbimeve e komoditeteve publike, të transportit, komunikimit dhe infrastrukturës, përfshirë territoret e përshtatura;

iii) nxitjen e jetës ekonomike, shoqërore e kulturore në nivel kombëtar e vendor;

iv) garantimin e burimeve të furnizimit të mjaftueshëm dhe veçanërisht atij jetësor;

v) garantimin e kushteve të sigurisë së jetës dhe të shëndetit publik, rendit publik dhe sigurisë kombëtare;

vi) nxitjen e zhvillimit të balancuar rajonal për të siguruar shpërndarje të qëndrueshme të popullsisë në vend në bazë të burimeve;

c) të nxitë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike, zonave të mbrojtura, monumenteve të natyrës, zonave të ndjeshme mjedisore dhe të peizazhit;

Planifikimi dhe zhvillimi i territorit si disiplinëshkencore por dhe veprimtari praktike është e lidhur ngusht me shumë shkenca dhe disiplina shkencore. Lidhja me shkencat tjera varet nga lloji i planit që përpilohet, lidhjet grupohen në dy kategori, edhe atë: standarde dhe speciale. Në kuadër të shkencave standarde bëjnë pjesë ato të cilat çdo herë janë prezent gjatë hartimit të planeve të niveleve dhe llojeve të ndryshme si: gjeografia, gjeodezia, hartografia, GIS-i, ekologjia, ekonomia dhe sociologjia, ndërkaq në kuadër të shkencave speciale bëjnë pjesë ato shkenca të cilat vetëm në raste specifike janë të nevojshme për përpilimin e planeve të territorit, si p.sh. urbanistika, ndërtimi, bujqësia, kimia, biologjia, turizmi, etj.

Me gjeodezinë dhe problemet që ajo zgjidh si dhe metodat gjeodezike mbi rievimin e terrenit, si dhe përcaktimi i raporteve ndërmjet sistemeve të koordinatave tredimensionale globale me ata një dhe dydimensionale lokale, janë aktivitete gjeodezike të cilat japin kontribut në planifikimin e qëndrueshme të hapësirës, duke harmonizuar të dhënat që jep gjeodezia në një sistem unik. Nuk mund të realizohet



planifikimi i territorit pa përpilimin e hartave përkatëse për paraqitjen e gjendjes aktuale dhe atë të projektuar.

Hartat e reja dixhitale që përpilohen dhe dixhitalizimi i atyre ekzistuese luan rol mjaft të rëndësishëm që kohët e fundit paraqitet si një ndër metodat bazë themelore për krijimin e bazës grafike mbi të cilin përpilohet plani hapësinor.. Pa harta dhe punime gjeodezike nuk mund të realizohet planifikim i territorit.

## **Tema 2: Mbrojtja e natyrës e përdorimi i tokës.**

**Mbrojtja e natyrës** është tërësia veprimtarive të njerëzve, është filozofia morale dhe lëvizja e fokusuar në mbrojtjen e specieve nga zhdukja, ruajtjen dhe restaurimin e habitateve, përmirësimin e shërbimeve të ekosistemit dhe mbrojtjen e diversitetit biologjik. Një sërë vlerash janë në themel të ruajtjes, të cilat mund të udhëhiqen nga biocentrizmi, antropocentrizmi, ekocentrizmi dhe sentientizmi, ideologjitë mjedisore që informojnë praktikën dhe identitetet ekokulturore. Kohët e fundit ka pasur një lëvizje drejt konservimit të bazuar në prova, e cila kërkon përdorimin më të madh të provave shkencore për të përmirësuar efektivitetin e përpjekjeve të ruajtjes. Që nga viti 2018, 15% e tokës dhe 7.3% e oqeanëve ishin të mbrojtura. Shumë ambientalistë vendosin një objektiv për mbrojtjen e 30% të territorit tokësor dhe detar deri në vitin 2030. Në vitin 2021, 16.64% e tokës dhe 7.9% e oqeanëve ishin të mbrojtura. Raporti i vitit 2022 mbi ndikimet klimatike dhe përshtatjen, nënvizon nevojën për të ruajtur 30% deri në 50% të sipërfaqeve të tokës, ujërave të ëmbla dhe oqeanëve të Tokës – duke i bërë jehonë qëllimit 30% të Konventës së OKB-së për Biodiversitetin. Në fund të fundit, këto lëvizje duhet të promovohen më tej për të inkurajuar biodiversitetin dhe për të ruajtur një ekosistem funksional.

Mbrojtja e mjedisit është tërësia e veprimtarive praktike që kryhen nga njerëzit të vecuar apo të organizuar nga qeveritë për të mbrojtjen e mjedisit natyror. Objektivat e tij janë të ruajnë burimet natyrore dhe mjedisin ekzistues natyror dhe, kur është e mundur, të riparojnë dëmtimet dhe tendencat e kundërta.

1. Ruajtja e mjedisit që ka si qëllim të kufizojë ndikimin e ndotjeve të industrisë, bujqësisë, transportit, ndërtimit si dhe tjera veprimtari të njeriut.

2. Ruajtja e natyrës që ka si qëllim të kufizojë deri në një minimum ndryshimet në natyrë (ekosistemet) siç janë efektet e ngrohjes globale, ruajtja e shtresës së ozonit, pakësimi i emetimit të gazrave, evitimi i shirave acide.

Mbrojtja e mjedisit duhet të praktikohet, në nivel individual, të organizatave dhe të qeverisë, në dobi të mjedisit natyror dhe të qenieve njerëzore. Mjedisi në të cilin jetojmë është shumë i rëndësishëm për ne, ai është burim i jetës së njeriut. Mbrojtja e natyrës dhe e mjedisit konsiderohen si pjesa më e rëndësishme e jetës në planetin tonë. Të gjitha proceset që çojnë në një sistem ekologjik të suksesshëm janë të lidhura me programin për përcaktimin e strategjisë dhe zhvillimin e mëtejshëm të objektivave në ruajtjen e natyrës e të mjedisit. Koncepti themelor i ekologjisë duhet të njihet fort mirë jo vetëm nga shkollat e mesme, shkollat e larta, universitetet, organet shtetërore, institutet shkencore por edhe nga akademitë përkatëse të cilat duhet të udhëheqin në mënyrë shkencore zgjidhjen e problemeve në fushën e ruajtjes së natyrës dhe mjedisit si dhe ato të ngrohjes globale. Po të njiheshin mirë të gjitha këto probleme sot nuk do të kishim shqetësimet e ndotjes së ajrit, ujit të tokës apo efektet e ngrohjes globale.

Ekologjia është themeli i ruajtjes së natyrës dhe të mjedisit dhe si shkencë e biologjisë shfrytëzon të dhënat shkencore të kimisë, të fizikës, të matematikës dhe të shumë shkencave tjera.

Ne nuk duhet të tregohemi të pakujdesshem. Sepse bota jonë ka një nivel të pakët oksigjeni, dhe plehurat që hidhen çdo ditë në rrugë nuk e shtojnë nivelin e oksigjenit ato e paksojnë tymi i makinave është shumë i dëmshëm gjithashtu.

Për shkak të presioneve të mbikonsumit, rritjes së popullsisë dhe teknologjisë, mjedisi biofizik po degradohet vazhdimisht. Kjo tashmë është njohur edhe nga qeveri të ndryshme të cilat kanë filluar vendosjen e kufizimeve në aktivitetet që shkaktojnë degradim mjedisor.

**VENDIM**  
**Nr. 811, datë 21.10.2020**  
**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT**  
**“STANDEDET SHITETËRORE PËR**  
**SPECIFIKIMET TEKNIKE TË**  
**INFORMACIONIT GJEHAPËSINOR**  
**NË SHQIPËRI – TEMA: PËRDORIMI**  
**I TOKËS”**

**“PLANIFIKIMI I PËRDORIMIT TË TOKËS”**

Planet gjeohapësore të vendosura në nivele të ndryshme të administrimit kanë nevojë të mbështeten nga plane të tjera të hartuara nga autoritetet publike në nivele të ndryshme ose edhe me plane gjeohapësore përtej kufirit të një kombi. Elementet e ndryshme të zonimit përtej kufijve mund të kenë një ndikim të madh të njëri-tjetri.

*Planifikimi i përdorimit të tokës rregullohet nga dokumentet zyrtare apo rregullore plotësuese të planifikimit gjeohapësor që përpunohen në nivele të ndryshme të administrimit.*

### **Përdorimi i tokës**

Toka është një burim natyror shumë i rëndësishëm, por metoda të gabuara të përdorimit të saj, kanë ndikuar në uljen e vlerave minerale, dëmtimin nga erozioni, ose zënien nga objektet urbane. Mënyra se si është përdorur sipërfaqja e tokës në periudha të ndryshme historike është e rëndësishme, sepse efektet zgjasin për një kohë të gjatë në mjedis edhe pasi veprimtaria e njeriut ka ulur intensitetin e saj mbi këtë territor. Ka një bazë ligjore që rregullon përdorimin dhe administrimin e tokave (bujqësor, pyjorë, livadhore, të pafrytesme, etj.) Tashmë ka dhe standard të miratuar me VKM që lidhën me planifikimin dhe paraqitjen e tyre në harta e

plane të ndryshme zhvillimi.

Ndryshimet në përdorimin e tokës paraqiten në dy forma; sipërfaqet e mbulesës së tokës të cilat mund të jenë shndërruar plotësisht, ose në sipërfaqe të cilat mund të jenë modifikuar. Mbi 80% e territorit të kontinentit Europian është modifikuar ose shndërruar plotësisht. Ky shëndërrim por i pa përcaktuar ka ndodhur dhe në vendin tonë. Vetëm fondi pyjor që nga vitet 1990 deri 2020 është pakësuar realisht rreth 30 % e sipërfaqes.

Braktisja e tokës bujqësore në vendin tonë është e lidhur me shkatërrimin e kooperativave bujqësore, pas vitit 1990, ndërsa dëmtimi i bimësisë natyrore e pyjeve për ndërtim dhe dru zjarri është i ndikuar nga levizja dhe ndërtimet e pakontrolluara si dhe mungesës së burimeve të tjera për ngrohje dhe gatim kryesisht në fshat.

Braktisja e tokës bujqësore, shpyllëzimi ka efekte negative, sepse shoqërohet me rritjen e vlerave të erozionit dhe proceseve të tjera të degradimit të tokës pyjore dhe bujqësore.

Për të parë ndryshimet e ndodhura në sipërfaqen e tokës të krijuara si rezultat i aktivitetit njerëzor, një rol të madh luajnë hartat e përdorimit të tokës. Ato gjejnë përdorim në institucionet vendimmarrëse, të cilat duhet të planifikojnë zhvillimin urban. Ato janë shumë të rëndësishme në ndërtimin e strategjive për përdorimin më të mirë të burimeve natyrore dhe shërbejnë për të treguar shtrirjen hapësinore dhe efektet mjedisore të shkaktuara nga aktiviteti njerëzor në një territor të caktuar. Studimet mbi përdorimin e tokës janë të rëndësishme, sepse ato na paraqesin në mënyre të plotë pasojat, që shkakton veprimtaria e njeriut në mjedis.

Braktisja e tokës bujqësore është e lidhur me zhvillimin bujqësor të një rajoni të caktuar dhe për të ndaluar procesin e braktisjes së tokës, duhet të zgjidhen problemet në sektorin e bujqësisë. Problemi i braktisjes së tokës është i vështirë për tu zgjidhur, por mund të merren masa për të ulur ndikimet në mjedis, që shkaktohen nga ky proces. Një nga mënyrat më të mira për të arritur mbrojtjen e tokës është ripyllëzimi, i cili mund të jetë natyral ose artificial. Duhet bërë inventarizimi i tokave të braktisura, të cilat duhet të menaxhohen më mirë nga pushteti vendor.

The top section contains three informational graphics. The first is a green-bordered box with a photo of a tree in a glass bowl. Text: "Ndotja e tokave !!!", "NDOTJA E TOKES". The second is a green-bordered box with text: "Ndotja e tokës paraqet ndotjen e sipërfaqes natyrore të Tokës nga aktivitetet industriale, komerciale, shtëpiake dhe bujqësore." The third is a blue-bordered box titled "\*DITA E TOKËS" with text: "\*Dita e Tokës është një ngjarje vjetore që festohet në të gjithë botën në 22 Prill për të demonstruar mbështetje për mbrojtjen e mjedisit. E parë e festuar në vitin 1970, tani përfshin ngjarje të koordinuara globalisht nga Rrjeti i Ditës së Tokës në më shumë se 193 vende." It includes images of a globe with a plant, hands holding a globe, and a globe with a recycling symbol.





### Tema 3: Mbrojtja e ruajtja e jetës së egër në pyll

“**Jeta e egër**” përfshinë tërësinë e kafshëve, insekteve, zogjve, etj. që jetojnë në pyje e kullota. Ka një rëndësi të madhe ruajtja e jetës së egër, pasi ajo mban ekuilibrin ekologjik në tokë. Jeta e egër ndihmon edhe në promovimin e aktiviteteve të ndryshme ekonomike që gjenerojnë të ardhura nga turizmi.

Kafshët e egra, është një term i cili tradicionalisht i referohet specieve të kafshëve të pazbutura, por që si kuptim ka ardhur duke u zgjeruar për të përfshirë në këtë kuptim edhe të gjithë organizmat që rriten ose jetojnë në një mjedis të egër në një zonë pa ndikim nga njerëzit.

“**Fauna e egër**” janë të gjitha llojet e nënllojet e vertebrorëve, jovertebrorëve dhe popullatat e tyre, që jetojnë në gjendje të lirë në habitatin e tyre natyror, të vendosura në mënyrë të përkohshme ose të përhershme në një territor të dhënë.

“**Habitate natyrore**” janë zonat tokësore, ujore apo të përziara, të dalluara nga tiparet gjeografike dhe abiotike, të cilat shërbejnë si mjedise të individëve, të popullatave, të llojeve ose të bashkësive të tyre.

“**Lista e kuqe**” janë llojet e faunës, të shpallura të mbrojtura me një akt normativ, konkretisht me urdhrin nr.146, datë 8.5.2007 të ministrit “Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës”.

“**Libri i kuq**” është botimi, që përmban përshkrimin, shpërndarjen dhe karakteristika të tjera të llojeve të listës së kuqe, si dhe masat për përmirësimin e statusit të tyre të rrezikuar.

Ruajtja e jetës së egër përfshinë tërësinë e veprimtarive njerëzore që kanë si qëllim mbrojtjen e jetës së egër. Në këtë tokë, jeta e egër është po aq e rëndësishme sa qeniet njerëzore. Por për fat të keq, jeta e egër në dekadat e fundit është gjithmonë në rrezik pasi ne, qenia njerëzore po e shkatërrojmë natyrën habitatet ku



zhvillohet jeta e egër, këto vetëm për të përmbushur nevojat tona personale.

Jeta e egër, dhurata e natyrës për njerëzimin, po ndihmon vazhdimisht në ruajtjen e ekuilibrit ekologjik të tokës. Por, për shkak të disa aktiviteteve njerëzore si vrasja masive e kafshëve të egra për dhëmbët, kockat, gëzofin, lëkurën etj. së bashku me rritjen e popullsisë dhe zgjerimin e fushave

bujqësore zvogëlon numrin e kafshëve të egra dhe shumë lloje të kafshëve të egra janë zhdukur.

**Ruajtja e kafshëve të egra** është procesi i mbrojtjes së të gjitha llojeve të bimëve dhe kafshëve të egra në habitatin e tyre. Siç e dimë, çdo krijesë e gjallë në këtë tokë kontribuon në ekosistemin në mënyrën e vet të veçantë, ruajtja e jetës së egër është bërë një nga detyrat më të rëndësishme për njerëzimin.

Veprimtaria e njeriut mbi natyrën përfshi dhe jetën e egër po rrezikon atë që quhet zhvillim i qëndrueshëm. Shumë kafshë janë në prag të zhdukjes për shkak të papërgjegjshmërisë së njeriut. Drurët dhe pyjet po zhduken nga toka çdo ditë si rezultat i shpyllëzimeve masive për të përfituar sa më shumë lëndë druri për industrinë. Si rezultat i kësaj veprimtarie, ekosistemi dhe ekuilibri i natyrës po përkeqësohet. Vendi ynë në tre dekadat e fundit ka humbur shumë nga jeta e egër në sasi pra janë paksuar ndjeshëm popullatat e gjahut në numër por dhe në cilësi pasi ka pasë disa kafshë dhe shpendë që janë zhdukur apo në rrezik zhdukje. Në këto rrethana del domosdoshmëri ruajtja e jetës egër kudo.

Rëndësia e ruajtjes së jetës së egër: - Nuk është e nevojshme të përshkruash shumë për rëndësinë e ruajtjes së jetës së egër. Ne nuk duhet të lejojmë që jeta e egër ose një pjesë e kafshëve të egra të zhduken nga kjo tokë.



**Ne duhet të mësojmë se si të jetojmë në paqe me kafshët e egra.**

Eshtë në zbatim “Ligji për mbrojtjen e faunës së egër” nr.10 006, datë 23.10.2008 i ndryshuar me Ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009, Ligji nr. 41/2013, datë 14.2.2013)

**Mbrojtja e faunës së egër ka si qellim:**

- a) ruajtjen e rimëkëmbjen e larmisë së llojeve dhe tërësinë e tyre gjenetike;
- b) mbrojtjen e habitateve, të rrugëve të shtegtimimit e të kushteve të shumimit të tyre;
- c) ruajtjen e integritetit të komuniteteve natyrore;
- ç) përdorimin e faunës së egër për qëllime studimore-shkencore, që sigurojnë rigjenerimin e tyre;
- d) rihyrjen e llojeve të faunës, të zhdukura apo të rrezikuara.

## **Kërkesat e mbrojtjes**

Për mbrojtjen e faunës së egër duhen pasur parasysh kërkesat e mëposhtme:

1. Sigurimi i mbrojtjes tërësore për faunën e egër, si dhe i mbrojtjes së veçantë për llojet e saj, në përputhje me gjendjen konkrete të llojit dhe të habitatit ku jeton, duke u dhënë status të veçantë mbrojtjeje llojeve të kërcënuara e në rrezik zhdukje.
2. Sigurimi i mbrojtjes së barabartë për llojet dhe i mbrojtjes së një lloji të veçantë, për të mos dëmtuar një lloj tjetër.
3. Ruajtja dhe rehabilitimi, kur është e mundur, i habitateve natyrore, i rrugëve të shtegtimimit dhe i krijimit të kushteve për shumimin e llojeve të faunës së egër.
4. Rimëkëmbja e popullatave të pakësuara të llojeve në një apo në disa habitate të caktuara.
5. Sigurimi i mbrojtjes së llojeve nga fatkeqësi natyrore, në rastet e dukurive epizootike dhe gjatë kushteve të vështira të motit, duke asistuar individë të llojeve të egra.
6. Shmangia e keqtrajtimit, e dëmtimit dhe e plagosjes së individëve të llojeve gjatë veprimtarive bujqësore, hidroteknike, të mirëmbajtjes e shfrytëzimit të pyjeve dhe veprimtarive të tjera ekonomike e shoqërore që mund t'i dëmtojnë.
7. Krijimi i zonave të mbrojtura, duke pasur si bazë habitatet e llojeve.
8. Shtimi ex-situ i llojeve të kërcënuara dhe endemike.
9. Kufizimi i përdorimit të llojeve të egra për qëllime koleksionimi dhe për çdo qëllim tjetër.
10. Mbrojtja e llojeve nga ndikimet negative të përhapjes e shumimit të llojeve invazive, në përputhje me masat “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.
11. Organizimi i kërkimeve shkencore për mbrojtjen e llojeve të faunës së egër.
12. Ndalimi dhe eliminimi i sjelljes çnjerëzore (mizore) mbi llojet e faunës së egër, si dhe i torturës ndaj tyre.
13. Nxitja për mbrojtjen e faunës së egër dhe promovimi i politikave e i qëndrimeve njerëzore për to.
14. Ruajtja e tërësisë gjenetike dhe sigurimi i numrit minimal të popullatave të llojeve.
15. Krijimi i qendrave të shpëtimit të llojeve të faunës së egër.
16. Mbrojtja nga sëmundjet infektive e zootonike.
17. Nxitja e përkrahja nga shteti i projekteve dhe i veprimtarive të biznesit, të OJF-ve e të donatorëve, që synojnë mbrojtjen dhe shtimin e llojeve të faunës së egër.
18. Rikthimi në natyrë i individëve të robëruar.

Ndër detyrat kryesore janë: Mbrojtja e llojeve të kërcënuara dhe endemike

1. Llojet e kërcënuara dhe endemike, të përcaktuara në listën e kuqe, gëzojnë mbrojtje të veçantë ligjore, që ka të bëjë me:

- a) hartimin dhe zbatimin e planeve të veçanta të veprimit, për ruajtjen e këtyre llojeve, sidomos kur shumimi i tyre, në kushte natyrale, është shumë i kufizuar;
- b) monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes faktike e të ecurisë së popullatave të tyre;
- c) shndërrimin e habitateve të tyre në zona të mbrojtura, që favorizojnë mbrojtjen dhe shumimin e tyre;
- ç) nxitjen e përkrahjen e nismave dhe të veprimtarive, që synojnë shtimin e popullatave të llojeve, nëpërmjet shumimit në gjendje robërie dhe lëshimin e tyre në mjediset natyrore;
- d) ndalimin dhe kufizimin e veprimtarive, që çojnë në shkatërrimin e llojeve të kërcënuara e endemike të faunës së egër, në zvogëlimin e numrit të popullatave të tyre, në dëmtimin e habitateve të tyre, të rrugëve të shtegtimit e të kushteve të shumimit;
- dh) hartimin dhe publikimin e librit të kuq të llojeve të mbrojtura;
- e) sensibilizimin e publikut për mbrojtjen e tyre.

2. Mbrojtje, sipas pikës 1, gëzojnë edhe llojet ndërkombëtarisht të mbrojtura, të përcaktuara në anekset e Konventës së Bernës, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8294, datë 2.3.1998 “Për ratifikimin e konventës për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës (Konventa e Bernës)”.

Ruajtja e numrit të popullatës së llojeve të faunës së egër

Shtimi i popullatave të llojeve të faunës së egër mbahet nën kontroll dhe rregullohet për të siguruar mbrojtjen e shëndetit të popullatave të llojeve, mbrojtjen e llojeve të faunës së egër e shtëpiake nga sëmundjet, shmangien e dëmtimeve në bujqësi, në pyje dhe në përbërës të tjerë të mjedisit, të shkaktuara nga shtimi i pakontrolluar i këtyre popullatave.



Gjeli i egër



Macja e egër

Numri i popullatës së një lloji të faunës së egër rregullohet me mënyrat njerëzore, duke mbrojtur habitatet dhe duke mos u shkaktuar dëmtime llojeve të tjera të faunës së egër. Gjuetia dhe tregtimi i kafshëve duhet të kontrollohet nga strukturat përkatëse tëqeverisëe cila ka

detyrë jo vetëm për të vendosur ligje të rrepta por të kërkojë zbatimin e përpikët të tyre në mënyrë që të këtë sukses në ruajtjen e kafshëve të egra.



## **Tema 4: Estetika e territorit dhe mbrojtja e mjedisit**

**Estetika**, përkufizohet si; "Shkenca që studion të bukurën në natyrë e në jetën shoqërore, ligjet e përgjithshme të krijimtarisë artistike e të përvetësimit estetik të realitetit dhe përmbajtjen, rrugët e format e edukimit estetik" Tërësia e pikëpamjeve që ka një krijues i veprave artistike a një dijetar për artin në përgjithësi ose për një lloj të veçantë arti. Ana e jashtme artistike e diçkaje, bukuri, hijeshi; tiparet e veçoritë estetike. Estetika e punës. Estetika e veshjes. Estetika e peizazhit, etj. Vlerat estetike të një peizazhit të caktuar arrihen nepërmjet arkitekturës, të sjelljes së njeriut me territorin ku ai jeton.

Natyra dhe fenomenet e saj janë kusht që njeriu si krijues i artit të ekzistojë, të krijojë, të modulojë, por ato nuk kanë domethënie pa njeriun. Shkurt për territorin dhe peizazhin.

Territor, është hapësirë tokësore e një vendi, e një krahine, brenda kufijve të caktuar; tokë. Territori i një shteti. Territori i fshatit, qytetit,

Peizazhi është pamje e natyrës, e një vendi, e njëterritori që rroket nga syri, pamja e natyrës që na del para sysh. Peizazh i bukur (i mahnitshëm, i zymtë). Peizazh pranveror (dimëror). Peizazh vjeshte. Sodit peizazhin.

Koncepti i peizazhit është, efekti pamor i realitetit nga pikëvështrimi njerëzor . Në peizazhin urban, niveli i projektimit teknik, shprehet në fakt para se të mendojmë për pamjen që do të ketë dhe karakteristikat e tij varen nga transformimet që kërkojmë për banimin, lëvizjen, ekonominë, etj...Qytetet, sidomos ato të mëdha, zhvillohen më bazë të këtyre kërkesave por, me plotësimin e tyre, dalin dhe nevojat e plotësimit të disa kushteve për peizazhin edhe nga ana estetike, me arsyen se edhe peisazhi është pjesë e një mjedisit të jetës reale.

Në epokën e sotme të zhvillimit urban, rritja në lartësi është bërë një farë simboli, përveçse nevojë për të shfrytëzuar sipërfaqen sa më tepër dhe ndërtesat e larta janë treguesi më i mirë për këtë. Kështu qytetet ekspozojnë dhe zhvillimin e tyre.

Realizimi i peizazhit ka katër motive: një përdorim simbolik të pamjeve natyrore; kuriozitetin për faktet dhe aspektet e vetë natyrës; një shpërhytyrim i natyrës nisur nga ndrojtja prej saj dhe dëshira për një harmoni utopike apo rregull fantastik i përfytyruar dhe i dëshiruar (jo real) nga vetë njerëzit.

Peizazhi tradicional është natyral, forma dhe drita që ne shohim, por, sidomos peizazhi urban, përmbledh edhe "gjurmët" e prezencës dhe veprimtarisë së njeriut.

Peisazhi kulturor është një vepër arti artificiale, e ndërtuar nga njeriu, nga një hapësirë natyrore. UNESCO e përkufizon atë si "përfaqësimi i kombinuar i veprës së natyrës dhe njeriut". Ndërsa në Konventën Evropiane të Peizazhit të Këshillit të Evropës të vitit 2000, ajo përcaktohet "si rezultat i veprimit dhe bashkëveprimit të faktorëve natyrorë dhe / ose njerëzorë".

Është një hapësirë shumë e përcaktuar territoriale që lidhet me një ngjarje ose me një person historik ose



Projekti për zhvillimin e Parkut kombëtar të Butrintit

autokton, gjë që i jep asaj një vlerë estetike dhe kulturore. Peizazhet kulturore, si elemente artistike, përmbajnë një vlerë të paprekshme dhe simbolike që flet, komunikon elemente të mjedisit të saj dhe të njerëzve që jetojnë atje.

Peizazhet kulturor, janë hapësira që njihen ose mbrohen në mënyrë të vazhdueshme nga komunitetet e afërta, prandaj shumë prej tyre janë emëruar si Trashëgimi Kulturor e

Njerëzimit, me qëllim garantimin e ruajtjes së tyre.

Nocioni i peizazhit kulturor ka qenë produkt i një marrëdhënjeve të re midis njeriut dhe mjedisit të tij, pjesërisht, falë një ndërgjegjësimi të ri për efektet që veprimi i tij mund të ketë në mjedis (ndryshimi i klimës)

Karakteristikat kryesore të një peizazhi kulturor mund të përmblihdën:

Kombinon veprimin natyror dhe veprimin njerëzor.

Vlera e lartë estetike.

Vlera simbolike.

Organizimi dhe struktura.

Karakter historik.

Nënkupton një vlerë të prekshme dhe të paprekshme.

Nuk ka një shtrirje të përcaktuar; domethënë mund të jetë një hapësirë shumë e madhe ose shumë e vogël.

Mund të jetë një vend industrial, një park, një kopsht, një varrezë ose një fushë.

### **Rëndësia e peizazheve kulturore**

Peizazhet kulturore janë gjithashtu të rëndësishme për shkak të dimensionit shpirtëror, jo material, të qenies njerëzore që ndikohet nga stimujt që ajo percepton nga mjedisi i saj i ngushtë.

Po kështu, një peizazh kulturor mund të ketë një ndikim shumë pozitiv në vetëvlerësimin e komunitetit në të cilin është futur, sepse mund të gjenerojë një ndjenjë të lartë të përkatësisë duke nxjerrë në pah në një mënyrë pozitive një aspekt të historisë ose kulturës së tij. Kjo sepse ato janë një lloj trashëgimie që zbulojnë

aspektet historike dhe kulturore të një territori, ndërsa shprehin gjendjen e marrëdhënies së atij komuniteti me botën e tij natyrore.

Ato mund të jenë hapësira ekologjike, për rekreacion dhe edukim, që ndihmojnë komunitetin të njohë dhe kuptojë më mirë vetveten, prandaj ato gjithashtu përfaqësojnë një element të identitetit kulturor që mund të kapërcejë brezat.

Në peizazhin urban, hapësira dhe drita janë kthyer në forma të perceptuara nga ne, të mpleksura me ato natyrore dhe konsiderohen si shenjë e progresit e statusit të kulturës sonë materiale. Kjo quhet edhe autoportreti i qytetërimit teknik ku, pjesa më e madhe e veprimtarisë i takon arkitekturës e cila ka dhe ndarjen e saj sociale. Por, si çdo pjesë e mjedisit, egziston dhe ndotja e peizazhit dhe nuk janë vetëm ndotja nga mbetjet urbane .



Peizazhi estetikë është një pjesë e rëndësishme e estetikës mjedisore. Mbrojtja dhe përpunimi i bukurive natyrore duke ruajtur karakteristikat e saj, llojet dhe zhvillimi me metodat dekorative janë qasjet e duhura në kohën që jetojmë;

Është e nevojshme dhe i jep shumë vlera, peizazhit natyror, dhe peizazhit artificiale kur ato harmonizohen natyrshëm me peizazhit kulturor. Peizazhi natyror është praktikë për lëvizje udhetime, etj. po nëse i shtohen dhe element të peizazhit kulturor, të tilla si ndërtesa fetare, skulpturë urbane, ura të lashta dhe manifestime e të tjera të qytetërimit njerëzor ai rivlerësohet shumë here dhe ju shëben një numri më të madh njerzish. Peisazhi estetikë, nuk mund të realizohet pa njohuri të thella që përfshijnë: gjeologji, gjeografi, gjeodezinë, arkitekturë dhe njohuri të tjera shkencore, me të integruara.

Disa veprimtari tradicionale njerëzore janë jetike për rritjen sociale dhe ekonomike, por në të njëjtën kohë mund të ndikojnë thellësisht mjedisin duke kontribuar në ndotjen dhe çlirimin e substancave të dëmshme. Me kalimin e viteve, rritja e ndërgjegjësimit për ndikimet që mund të kenë veprimet njerëzore në mjedis ka çuar në njohjen e nevojës për një transformim teknologjik.

## **Tema 5. Qëllimi i planifikimit të territorit**

Qëllimi dhe detyrat që zgjidh planifikimi i territorit mbështetën në kërkime dhe disiplina shkencore ku analizohen ligjet natyrore dhe shoqërore për të vendosur raporte të drejtat të qëndrueshme midis hapësirës dhe njeriut. Është një synim që kryesisht realizohet nëpërmjet procesit të prodhimit, si aktivitet i vetëdijshëm i njeriut me të cilin drejtpërsëdrejti ndikon në ndryshimin e natyrës, zotëron me të dhe e përshtat sipas nevojave të tij.

Mënyra e qasjes ndaj planifikimit të territorit, pikërisht ndaj përcaktimit të metodave, instrumenteve dhe masave për ndryshim të vetëdijshëm të hapësirës nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të planeve hapësinore dallon në shtete të ndryshme, që paraqiten si rezultat i nivelit të ndryshëm të zhvillimit të tyre dhe elementeve karakteristike rajonale e mikrorajonale.

Veprimtaritë konkrete për planifikimin e territorit gjithmonë bazohen në analizën empirike të gjendjes castit, ndryshimeve që ndodhin dhe marrëdhëniet në kuadër të sistemit hapësinor, aplikimin e metodave dhe elementeve të veçanta të sistemit hapësinor dhe masat për orientimin e aktiviteteve në drejtim të shfrytëzimit racional të territorit. Duke u nisur nga fakti se të gjitha veprimtaritë njerëzore zhvillohen në territor të caktuar gjeografik ose ekonomik, planifikimi i territorit si disiplinë shkencore përfshin aspektin territorial të zhvillimit shoqëror-ekonomik, si rezultat i të cilit përshpejtohet ose ngadalësohet dinamika e rritjes ekonomike dhe zhvillimit të përgjithshëm shoqëror. Përfshirja e aspektit territorial në kuadër të planifikimit hapësinor ka ndikuar që rajonizimi dhe zhvillimi i njëtrajtshëm shoqëroro- ekonomik të paraqiten si elemente me rëndësi primare.

Edhe përkundër pikësynimit të planifikimit hapësinor për zhvillim të njëtrajtshëm ekonomik shoqëror të të gjitha rajoneve, ligjet e ekonomisë së tregut pamundësojnë realizimin e plotë të tij mbarë territorit të një fshat, krahine, bashkie dhe shteti.

Arkitektura e peizazhit, dizajni ekologjik ofron projektim dhe planifikimi ekologjik të peizazhit. Duhet të njihen konceptet dhe temat e rëndësishme për praktikën bashkëkohore të projektimit dhe planifikimit ekologjik në një format shumë të aksesueshëm dhe me ilustrim të pasur. Duke u fokusuar kryesisht në mjediset urbane, njohuri të duhet të përqëndrohen në marrëdhëniet midis teorisë së projektimit ekologjik dhe metodave të projektimit. Është me shumë rëndësi të njihën raportet, strukturat dhe funksionet bazë të sistemeve natyrore dhe njerëzore përmes parimeve të ekologjisë së peizazhit.

Marrëdhënja reciproke ndërmjet njeriut, gjallesave të tjera dhe natyrës paraqet një ndër qëllimet kryesore të planifikimit të territorit, e cila ka për detyrë që të ruajë marrëdhëniet e qëndrueshme, të kultivojë dhe zhvillojë në nivel sa më të lartë. Këtu ekologjia si disiplinë shkencore që trajton gjendjen e çastit ekologjik të hapësirës si rezultat i marrëdhënieve të njeriut me mjedisin dhe parashikimeve për të ardhmen



me kusht që marrëdhëniet vazhdojnë të zhvillohen me trend të qendrueshëm, jep kontribut të dukshëm gjatë përpilimit të planeve territoriale të niveleve të ndryshme.

Lidhja ndërmjet ekologjisë dhe planifikimit hapësinor si disiplina të veçanta shkencore posaçërisht vjen në shprehje gjatë përcaktimit të masave për mbrojtjen e mjedisit jetësor nga ndotjet e llojeve të ndryshme, si dhe ruajtjen e baraspeshës ekologjike duke parandaluar shfrytëzimin e paplanifikuar dhe pakontrolluar të pasurive natyrore, gjithë këto të përfshira në planet hapësinore të llojeve të ndryshme. Lidhja e tillë zë vend të rëndësishëm në metodologjinë e planifikimit hapësinor, pasi që paraqet element mjaft të rëndësishëm që lidhet drejtpërsëdrejti me gjendjen shëndetësore të opullatës dhe parandalon paraqitjen e epidemive të ndryshme ose sëmundjeve masive.

Përpilimi i planeve territorial ku aspekti ekologjik është i përfshirë tërësi duke krijuar kushte të përshtatëshme për zhvillimin e shoqërisë në një ambient të pastër ekologjik, njëkohësisht është në të mirën popullatës, botës bimore, asaj shtazore dhe atmosferës. Në këto kushte ekologjia bën pjesë në shkencat që janë pjesë përbërëse e domosdoshme e nëhartimin të gjitha planeve territoriale të gjitha niveleve.

Rezultatet nga analiza ekonomike e territorit për të cilin përpilohet plani japin mundësi për orientimin e zhvillimit ekonomik duke ja hapur mundësitë popullatës së rajonit të caktuar të shkëmbejnë mallra me territoret tjera fqinje dhe më larg, edhe atë në aspekt lokal, nacional dhe ndërkombëtar.

Ekonomia po ashtu jep kontribut të veçantë gjatë procesit të planifikimit të territorit me analizat e saj mbi mundësitë e krijimit të zonave industriale të reja, zhvillimit të bujqësisë, blegtorisë, turizmit etj, si dhe arsyeshmërinë ekonomike të shfrytëzimit të pasurive natyrore dhe investimeve për realizimin e planit territorit. Zhvillimi ekonomik të rajonit të caktuar, mundëson përfshirjen e të gjitha elementeve pozitive që sjell ekonomia nga hulumtimet e saj, si dhe ti shmangë të gjithë rreziqet potenciale të përcaktuar po ashtu gjatë analizave ekonomike.

Analizat sociologjike në funksion të planifikimit të territorit, njohja e traditave dhe kulturës së popullatës vendase dhe asaj të ardhur paraqet element që detyrimisht duhet të jetë pjesë e planit territorit, si element kyç për përfshirjen e plotë e të gjitha specifikave të popullatës lokale në planifikimin e zhvillimit të territorit, duke ruajtur, kultivuar dhe zhvilluar traditën dhe kulturën lokale. Kjo nënkupton se analizat sociologjike në funksion të planifikimit territorial bëhen me qëllim të krijimit të kushteve sa më optimale për funksionim normal dhe të pandërprerë të qytetarit në kuadër sistemit juridik shoqëror. Sociologjia gjatë përpilimit të planeve hapësinore ndihmon planifikimin hapësinor duke ofruar të dhëna për orientimin e zhvillimit të shoqërisë drejt krijimit të kushteve optimale të qytetarëve për jetesë, punë, arsimim, art, kulturë, sport, pushim, rekreacion, etj.



## **Tema 6: Detyrat e planifikimit të territorit**

Planifikimi i territorit është një ndër disiplinat e reja shkencore shoqërore, i cili si veprimtari e organizuar shoqërore paraqitet në fillim të shekullit të XX, ndërsa si veprimtari i ushtruar në mënyrë spontane paraqitet që prej momentit kur ka filluar të zhvillohet vetëdija e njeriut për organizimin e mjedisit ku jeton dhe vepron, si dhe mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe sulmet e mundshme të të njerëzve (fiseve) ose botës shtazore. Duke pasur parasysh objektivat dhe detyrat mjaft komplekse të planifikimit të territorit, si dhe lidhjen e tij të ngushtë me numër të madh të disiplinave tjera shkencore, planifikimi territorial lidhen me mesin e shekullit XX, në kohën kur shoqëria arriti shkallë të lartë të zhvillimit ekonomik shoqëror. Në të kaluarën planifikimi i territorit nuk ka qenë aktivitet i organizuar për rregullimin e hapësirës sipas kërkesave reale të njeriut konform karakteristikave të terrenit. Nëshekuj mëparënjerëzit nuk kanë orientuar zhvillimin e hapësirës ku jetojnë dhe veprojnë në formë të organizuar dhe me standarde të përcaktuar paraprakisht, por proceset e zhvillimit kanë qenë të paorganizuara dhe tepër subjektive duke pasur parasysh vetëm nevojat e grupit të caktuar të personave në arealin ku ata jetojnë dhe më gjerë, pa e analizuar ndikimin e veprimtarive të tyre ndaj grupeve tjera që jetojnë në atë territor dhe rajonit në përgjithësi.

Në fazën e zhvillimit të paorganizuar të hapësirës, ka ekzistuar ligji i forcës-sundimit të një grupi të njerëzve mbi të tjerët, që nënkupton se hapësira është organizuar në formë dhe mënyrë që i përgjigjet vetëm grupit sundues, pa i marrë parasysh faktorët tjerë për zhvillimin e hapësirës e me atë edhe të shoqërisë në përgjithësi.

Prirjet dhe rrymat të ndryshme për formimin e një metodologjie standarde dhe unike për krijimin e planeve territorial tëmbarë botës, nën ndikimin e traditës lokale, kulturës, elementeve natyrore, nivelit të zhvillimit të shoqërisë, sistemit shtetëror etj., çdo shtet ka zhvilluar sistem autentik të planifikimit të hapësirës. Njohja e përvojave të shteteve tjera jep mundësi të shfrytëzimit të përvojave më të mira të tyre. Duke u nisur nga kjo, është e nevojshme të njihen përvojat dhe standardet në vendet të zhvilluara botërore, si Britania e madhe, Gjermania, Franca, SHBA, etj-të, përvojat e të cilëve mund dhe duhet të shfrytëzohen si bazë për zhvillimin e mëtejshëm të planifikimit territorial tek ne.

Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, në territorin e vendit tone mbisundonin vendbanimet rurale dhe orientimi agrar i ekonomisë. Fillimet e planifikimit të territorit sipas standardeve të vendeve evropiane lidhen me vitet 20 kur filloi planifikimi i zhvillimit të Tiranës nga projektues austriak pastaj italian. Deri në vitin 1990 vetem për Tiranën janë hartuar 7 plane rregulluese o se plane zhvillimi territorial.

Kuptimi i sotëm i planifikimit territorial si proces kompleks teknik dhe planifikues në vendin tone filloi të zhvillohet pas luftës së dytë botërore, fillimisht duke u aplikuar në hapësirat e qyteteve dhe pastaj duke u zhvilluar zonat që i qarkonin ato.

## **Planifikimit i territorit ka si qëllim të zgjidhi disa detyra kryesore:**

Zbulimi dhe përshkrimi teorik i ligjeve objektive natyrale, ekonomike dhe shoqërore si elemente themelore të proceseve zhvillimore në kuadër të sistemit hapësinor.

Përcaktimi i përmbajtjes së planeve teritoriale të gjitha niveleve, si dhe metodologjisë, standardeve, instrumenteve dhe masave për përpilimin dhe implementimin e tyre.

Përcaktimi i politikës së zhvillimit rajonal

Trajtim i veçantë ndaj sektorëve ekonomik me interes të veçantë për territorin që përpilohet plani hapësinor, si p.sh turizmit, bujqësia , etj.

Zhvillimi i teorisë dhe politikës së urbanizimit të territorit dhe krijimit të sistemit të përgjithshëm urban në kuadër të një shteti dhe më gjerë.

## **Mbrojtja e mjedisit jetësor.**

Fazat kryesore të procesit të planifikimit territorit

Procesi i planifikimit territorit përbëhet prej 4 fazave kryesore: analiza, sinteza (përpilimi i planit hapësinor), miratimi dhe realizimi.

Në bazë të katër fazave të lartshënuara, pushteti duhet ti përcaktojë qëllimet e përgjithshme dhe ata konkrete të planifikimit territorit, në bazë të konsultimeve me të gjitha subjektet shtetërore dhe ata private.

Gjatë punëve përgatitore me vlerë të veçantë janë analizat e ndryshme si?

Sistematizim dhe studim i literaturës profesionale dhe shkencore.

Sistematizim dhe studim i të dhënave statistikore dhe dokumenteve tjera që japin informacion për atë territor.

Organizimi i hulumtimeve plotësuese si të domosdoshme për përpilimin e planit hapësinor.

Sigurimi i numrit të mjaftueshëm të kuadrove prej profileve të ndryshme dhe prej institucioneve përkatëse.


Formulimi i proceseve të veçanta metodologjike dhe të instrumenteve analitiko-planifikuese konform karakterit, qëllimit dhe detyrave të planit hapësinor. Përpilimi i planit operativ për gjithë procesin e punës.

Në aspektin social synohet për zhvillim territorial të njëtrajtshëm, pra sheti duhet të sigurojë kushte të përafërta për jetesë dhe punësim për të gjithë qytetarët, si elemente mjaft të rëndësishme për barazi të plotë të gjithë qytetarëve dhe zgjidhja e problemeve sociale. Përkundër aspekteve ekonomike dhe sociale, aspekti politik i zhvillimit të njëtrajtshëm territorial është një ndër parimet themelore të shoqërisë demokratike, pasi dallimet e mëdha në standardin jetësor dhe pozitën sociale ndërmjet qytetarëve në territore të ndryshme mund të sjellin pakënaqësi massive dhe deri në destabilizim politik të shtetit.

Procesi i planifikimit të territorit, planifikimit është punë në ekipe të formuara nga ekspert të fushave të ndryshme, me ç'rast mundësohet bashkëpunim dhe koordinim i veprimtarive ndërmjet tyre gjatë përcaktimit të objektivave, strategjive, metodave dhe masave për zgjidhjen e problemeve me të cilat ndeshën gjatë



përpilimit të planeve territoriale. Formimi i ekipeve të përziera duhet të realizohet me ekspert të fushave të ndryshme ose të nëndisiplinave shkencore në kuadër të një fushe shkencore. Edhe përkundër përparësisë së ekipeve të formuara nga ekspert të fushave të ndryshme përkatëse, gjatë qasjes nderdisiplinore bashkëpunimi është i limituar, pasi që aktivitetet zhvillohen ndaras në kuadër të fushave përkatëse, ndërsa koordinimit ndërmjet tyre realizohet nëpërmjet organizimit të mbledhjeve të përbashkëta. Personat e angazhuar në hulumtimet shkencore dhe përpilimin e planeve territorial i kanë njohuritë plotë mbi të gjitha metodat, masat dhe instrumentet e ndërmarra.



Në funksion të planifikimit territorit do të veçohen gjeodezia praktike, gjeodezia inxhinierike, fotogrametria, gjeodezia satelitore dhe teledeteksioni. Metodat dhe saktësia që i ofron gjeodezia planifikimit hapësinor, mundëson përpilim dhe realizim të planeve hapësinore të të gjitha llojeve dhe përfshirjeve territoriale (deri

në ata kontinentale-globale) me tërësi, shpejtësi dhe saktësi konform standardeve të planit përkatës hapësinor.

Mundësia e analizave hapësinore që ofrojnë sistemet GIS (Geographic Information System- Sistemi i informacionit gjeografik) janë themelore në procesin e planifikimit territorial. Përdorimi i sistemeve GIS ofrojnë rezultate me cilësi mjaft të lartë, ku shpejtësia e realizimit të analizave hapësinore është disa minutëshe e në raste të veçanta disa orëshe. Këtu vlen të përmenden formimi i modelit dixhital të terrenit, modelit dixhital të relievit, modelit dixhital të sipërfaqes, lidhjes topologjike ndërmjet objekteve dhe proceseve hapësinore, integrimin e të dhënave nga baza të ndryshme në formë të GIS-it.

Hapësira ekologjike paraqet sistem të lidhjeve dhe raporteve ekzistuese dhe atyre në zhvillim e sipër ndërmjet botës së gjallë dhe natyrës, si dhe ndërmjet njeriut me botën shtazore e bimore dhe natyrën. Sipas karakteristikave të përgjithshme hapësira ekologjike më së shumti i përngjan hapësirës gjeografike, si hapësirë fizike dhe ndërthurje e shumë elementeve që gjenden në hapësirë të njëjtë. Lidhja e ekologjisë me mjedisin jetësor të njeriut është si rezultat i luftës për ekzistencë dhe zhvillimit të kushteve për jetesë, si kundërpërgjigje ndaj kanosjeve të shumta që vinë për prishjen e baraspeshës jetësore të njeriut që buron në bazën materiale dhe paragjykimeve të materializuara për zhvillim në kohën kur kërkesat e shoqërisë janë rritur dukshëm. Orientimi i ekologjisë në analizën e mjedisit jetësor të njeriut është si rezultat i zhvillimit dhe përqendrimit të shoqërisë njerëzore në hapësira të vogla gjeografike që drejtpërsëdrejti ndikon në degradimin e hapësirës e me atë edhe kërcënon jetesën e botës së gjallë.

Hapësira e pastër natyrore gati se nuk ekziston. Ajo është modifikuar nga ana njeriut, i cili me aktivitetet e vetëdijshme e ka ndryshuar atë dhe e ka adaptuar konform nevojave të tij duke e transformuar në një hapësirë natyrore të modifikuar (artificiale), me ç'rast njeriu paraqitet si faktor i rëndësishëm i cili në formë interaktive ndikon në ndryshimin e natyrës. Ndikimi i njeriut rritet paralelisht me zhvillimin tekniko-teknologjik, ku njeriu dhe natyra paraqiten si dy subjekte në gjendje lufte ndërmjet vete. Ndryshimet që ndodhin nga ndikimi i njeriut kanë karakter kohor dhe kanë ndikim në periudhë të caktuar kohore, të cilat mund të shkaktojnë pasoja pozitive ose negative në jetesën e gjeneratave të ardhshme.

## **Tema 7: Institucionet që merren me planifikimin e territorit**

Institucionet kryesore që merren me planifikimin e territorit:

**Këshilli i Ministrave**, merr vendime për miratimin e strategjive të zhvillimit dhe planifikimit të territorit.

**Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT)** është organ kolegjial që funksionon pranë Këshillit të Ministrave dhe kryesohet nga Kryeministri. KKT përbëhet nga Kryetari, dhe nga 8 anëtarët, emëruar sipas VKM-

**Këshilli Kombëtar i Territorit**, në fushën e planifikimit të territorit ka këto kompetenca:

- a) vendos miratimin, miratimin me ndryshime ose shtyrjen për shqyrtim të mëvonshëm të dokumenteve të planifikimit, kërkuar për miratim nga autoritetet e planifikimit, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
- b) vendos për miratimin e dokumenteve të planifikimit sektorial, të përcaktuara me legjislacion të posaçëm, dhe që kanë efekte në territor;
- c) përcakton rëndësinë kombëtare të një çështjeje, zone ose objekti në planifikimin e territorit, dhe miraton planet e detajuara për zona të rëndësisë kombëtare, kur parashikohen të tilla nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit.

Gjithashtu, KKT është autoriteti përgjegjës për vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për llojet e zhvillimit komplekse, të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit dhe ato që lidhen me çështje, zona, objekte të rëndësisë kombëtare apo me investime strategjike për interesat e vendit.

**Agjencia e Zhvillimit të Territorit është në rolin e Sekretariatit Teknik të KKT-së**

**Këshillin Bashkiak, miraton Planin e zhvillimit të territorit dhe palne të tjerë në nivel bashkie, etj.**

**Kryetari i bashkisë**, është pësoni që propozon dhe realizon Planin e zhvillimit territorial në nivel bashkie. Autoriteti përgjegjës për miratimin “Plani i Detajuar Vendor (PDV). e është kryetari i bashkisë,

### **7.1 Parimet mbi të cilat mbështetet qasja dhe politikat në planifikimin dhe zhvillimin e territorit.**

Ministria, për përmbushjen e programit të qeverisë, si dhe synimeve dhe objektivave, do të mbështetet mbi disa parime kryesore, të cilat mund të klasifikohen në 1) parime të qeverisjes së mirë territoriale; 2) parime të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

- a) Parimi Demokratik:
- b) Parimi i Pjesëmarrjes:
- c) Parimi i Integritit dhe Bashkërendimit:
- d) Parimi i Proporcionalitetit
- e) Decentralizimi dhe kompetencat e qarta mes autoriteteve

“Planifikimi si një proces pune në vazhdimësi”, qasja bashkëkohore e prezantuar në ligj ku procesi i planifikimit trajtohet si një cikël i vazhduar që vendos në një marrëdhënie të ndërsjellë dhe të ndërvuarur të

gjitha dokumentet e planifikimit, të cilat përbëjnë instrumente që u përgjigjen dinamikave të aktivitetit njerëzor dhe territorit.

Kemi këto tipo kryesore të planeve:

“PDV”, Plani i Detajuar Vendor.

“PDZRK”, Plani i Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare.

“PKS”, Plani Kombëtar Sektorial.

“PPKT”, Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit.

“PPV”, Plani i Përgjithshëm Vendor.

“PSNQ”, Plani Sektorial në Nivel Qarku.

“PSNB”, Plani Sektorial në Nivel Bashkie.

## **7.2 Planet e renditura sipas rëndësisë dhe strukturat e miratimit të tyre**

**1. Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit (PPKT) miratohet nga Këshilli i Ministrave** në përputhje me pikën 1, të Nenit 58, të ligjit. Dokumenti i Planit të Përgjithshëm Kombëtar i Territorit (PPKT) hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave dhe botimit të plotë të dokumenteve të tij në Fletoren Zyrtare. Planet kombëtare sektoriale (PKS) hartohen nga ministrinë me qëllim zhvillimin strategjik të një ose më shumë sektorëve sipas fushave të kompetencës.

**2. Planit Kombëtar Sektorial (PKS) miratohet nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) në përputhje** me shkronjën “b”, të nenit 7, të ligjit. Plani Kombëtar Sektorial zbatohet nëpërmjet planeve të detajuara për zonat e rëndësisë kombëtare, planeve sektoriale në nivel qarku, planeve të përgjithshme vendore dhe planeve sektoriale në nivel bashkie, si edhe projekteve pilot të investimeve kapitale /strategjike, sipas planit të veprimeve dhe rregullores së tij.

**3. Plani i Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare (PDZRK) miratohet nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) në përputhje** me pikën 4, të nenit 18 të ligjit. Dokumenti i planit të detajuar për një zonë të rëndësisë kombëtare (PDZRK) hyn në fuqi me botimin e plotë në regjistër të vendimit të KKT-së dhe dokumenteve shoqëruese të tij, në përputhje me pikën 2, të nenit 56, të ligjit.

**4. Plani Sektorial në Nivel Qarku (PSNQ). miratohet nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) në përputhje** me nenin 25 të ligjit. Baza e gjykimit për vendimmarrjen mbi miratimin e PSNQ-së përbëhet nga dokumentet e përmendura në pikën 3 të këtij neni. Vendimi i KKT-së botohet në regjistër dhe, në çdo rast edhe në faqen zyrtare të sekretariatit të KKT-së, autoritetit përgjegjës për planifikimin dhe Agjencisë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit, në përputhje me pikën 4, të nenit 25 të ligjit.

\





## 5. Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV), përmban:

- a) Planin e përdorimit të tokës;
- b) Planin e infrastrukturave dhe shërbimeve publike;
- c) Planin e mbrojtjes së mjedisit;
- ç) Planin e veprimeve për zbatimin e PPV-së;
- d) Hartat shoqëruese.

## 6. Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV), ose pjesët përbërëse të tij miratohen në Këshillin Bashkiak, në përputhje me nenet 12, pika 2 dhe 13 të ligjit.

Shqyrtimi i dokumentit të planit ose pjesëve përbërëse të tij realizohet sipas këtyre përcaktimeve:

- a) AKPT-ja kryen shqyrtimin e përputhshmërisë së dokumentacionit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e botimit dhe e paraqitjes për shqyrtim të dokumentacionit të plotë.
- b) Në përfundim të periudhës 30-ditore të shqyrtimit të dokumentacionit, Agjencia harton dhe boton në Regjistër raportin e vlerësimit teknik të PPV-së dhe aktin e përputhshmërisë, sipas rastit.

Vendimi i miratimit të Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV), ose pjesëve përbërëse të tij nga Këshilli Bashkiak botohet në regjistër dhe në çdo rast edhe në faqen zyrtare të autoritetit përgjegjës, brenda 10

(dhjetë) ditëve nga data e miratimit, në përputhje me pikën 4, të nenit 56 të ligjit. Pas botimit në regjistër të dokumentacionit, subjekt miratimi, aktit të përputhshmërisë së Agjencisë ose deklaratës së përputhshmërisë në heshtje, si edhe pas botimit të vendimit të miratimit të Këshillit Bashkiak, autoriteti përgjegjës bën kërkesën për shqyrtimin dhe miratimin e dokumentacionit në Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT). Dokumentacioni, subjekt miratimi, miratohet nga KKT-ja në përputhje me shkronjën “a”, të nenit 7 të ligjit, bazuar në dokumentacionin e përmendur në pikën 2, të nenit 61.

Dokumenti i Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) apo pjesët përbërëse të tij subjekt miratimi, hyjnë në fuqi me botimin e plotë në regjistër të vendimit të KKT-së dhe dokumenteve shoqëruese të tij, në përputhje me pikën 2, të nenit 56 të ligjit. 2. Vendimi i KKT-së së bashku me dokumentacionin e plotë shoqëruar botohet në regjistër dhe në çdo rast, në faqen zyrtare të sekretariatit të KKT-së dhe autoritetit përgjegjës për planifikimin, brenda 15 ditëve nga data e miratimit, në përputhje me pikën 4, të nenit 25 të ligjit.

**7. Plani Sektorial në Nivel Bashkie (PSNB) . Autoriteti përgjegjës për miratimin e PSNB-së është Këshilli Bashkiak.** Vendimi i miratimit të planit ose pjesëve përbërëse të tij nga Këshilli Bashkiak botohet në regjistër dhe, në çdo rast edhe në faqen zyrtare të autoritetit përgjegjës, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit, në përputhje me pikën 4, të nenit 56 të ligjit.

**8. Plani i Detajuar Vendor (PDV). Autoriteti përgjegjës për miratimin e PDV-së është kryetari i bashkisë, në përputhje me shkronjën “dh”, të pikës 1, të nenit 13 të ligjit.** Kryetari i bashkisë merr vendimin për miratimin e planit të detajuar vendor, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e paraqitjes për shqyrtim të dokumentacionit të plotë përfundimtar, pasi ka informuar palët e interesuara përmes faqes zyrtare të bashkisë, si dhe një a më shumë mjeteve tradicionale të informimit dhe, në rast se kërkohet, kryen takime publike me ta. Kryetari i bashkisë vendos miratimin e planit të detajuar vendor, bazuar në raportin teknik, të përgatitur nga strukturat përgjegjëse të planifikimit të autoritetit vendor, vetëm në rast se nuk shprehen kundër banorët që kanë në pronësi më shumë se një të tretën e sipërfaqes së zonës përkatëse të zhvillimit. Dokumenti i planit të detajuar vendor hyn në fuqi me botimin e plotë në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit të vendimit të miratimit nga kryetari i bashkisë dhe dokumenteve përbërëse të PDV.

### **7.3 Zonat turistike dhe parimet bazë**

1. Zonat turistike përbëhen nga zona me vlera natyrore të peizazhit, historike, kulturore, sportive, shëndetësore dhe pushimi.
2. Zonat turistike përcaktohen sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi.
3. Parimet e planifikimit dhe të projektimit të zonave turistike janë:
  - a) Ruajtja dhe mbrojtja e territoreve dhe mjediseve natyrore dhe me vlera të trashëgimisë historike dhe kulturore nga urbanizimi dhe zhvillimi.

- b) Ruajtja e zonave, që përfshihen në territoret bujqësore dhe përdorimi i tyre për agroturizëm bëhen sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje dhe legjislacionit të posaçëm.
- c) Urbanizimi i kontrolluar i qendrave të banuara në zonat turistike bëhet në harmoni me mjedisin, tokën bujqësore dhe burimet natyrore, pa ndotur ujin, ajrin dhe tokën, pa ndryshuar vlerat e biodiversitetit lokal dhe pa shkaktuar ndikim negativ në shëndetin e njeriut.
- ç) Përdorimi i mjedisit detar vetëm për qëllime që i shërbejnë ruajtjes së tij dhe aktiviteteve ekonomike dhe çlodhëse të lejuara sipas legjislacionit të posaçëm.
- d) Promovimi i ekoturizmit përkundrejt formave të turizmit masiv.

- **LIGJI NR. 107/2014, DATË 31. 7. 2014, “PËR PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E TERRITORIT”**,

- **VENDIM KM Nr. 686, datë 22.11.2017 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT”**

*Rregullorja e planifikimit të territorit është hartuar në zbatim të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me qëllim përmbushjen dhe shtjellimin e përcaktimeve të tij. Rregullorja e planifikimit të territorit paraqet rregulla të unifikuara për strukturën, përmbajtjen dhe hapat e hartimit, zbatimit, monitorimit të zbatimit të planeve, me qëllim detajimin e procedurave të planifikimit në nivel qendror dhe vendor dhe arritjen e njëtrajtshmërisë së formës e të strukturës së dokumenteve të planifikimit në zbatim të ligjit.*